



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 4, datë 10.03.2025

PËR MIRATIMIN PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR NËNSHKRIMIN E AKTMARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET SIPËRMARRËSIT “DULE” SHPK DHE PËRFITUESIT BASHKIA DURRËS, PËR RIKONSTRUKSIONIN E QENDRËS SHËNDETËSORE RRASHBULL, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRASHBULL, BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b” dhe nënpika 1.2, shkronja “c”, nenit 54, shkronja e/1, nenit 55, pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1003, datë 10.12.2010, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Rashbull, të Qarkut të Durrësit”, kërkesës që mban nr. 88 prot., datë 01.10.2024 të subjektit “Dule” shpk, administruar nga Bashkia me nr. 14094 prot., datë 04.12.2024, me anë të së cilës shprehet vullneti për të rikonstruktuar Qendrën Shëndetësore Rrashbull, Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, shkresës nr.570/3 prot., datë 04.12.2024, ardhur nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës, e protokolluar në Bashki me nr.14230, datë 06.12.2024, me lëndë: “Përcjellje dokumentacioni”, Ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994, “Për sponsorizimet”, i ndryshuar, VKM-së nr. 408 datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Udhezimit nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin për dhënie e autorizimit për nënshkrimin e aktmarrëveshjes së financimit ndërmjet sipërmarresit “Dule” shpk dhe përfituesit Bashkia Durrës, për rikonstruksionin e Qendrës

Shëndetësore Rrashbull, Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, që mban nr. 15 të listës së transferimit, miratuar me VKM-në nr. 1003, datë 10.12.2010, “Për miratimin e listës paraprahe të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Rrashbull, të Qarkut të Durrësit”.

2. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike si dhe Njësia Administrative Rrashbull për vijimin e procedurave të mëtejshme në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 11.03.2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 184/2 prot.

Durrës, më 17.3.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.4 datë 10.03.2025," Për miratimin e dhënies së autorizimit për nënshkrimin e aktmarrëveshjes së financimit ndërmjet sipërmarrësit "DULE" shpk dhe përfituesit Bashkia Durrës , për rikonstruksionin e qendrës shëndetësore Rrashbull, Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI